

Data 13/07/2023

## PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS -PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “REHABILITIMI I TUNELIT TË SHKARKIMIT PRANË DIGËS ZADEJË”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PUNIME NDËRTIMI-45210000-2.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 126,859,115 (NJËQIND E NJËZET E GJASHTË MILION E TETËQIND E PESËDHJETË E NËNTË MIJË E NJËQIND E PESËMBËDHJETË) LEKË, PA TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor KESH sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

#### ***Argumentimi:***

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** Bazuar sa më sipër, sipas Shtojcës 8.

#### ***Argumentimi:***

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në

kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

**2.2.2** Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e

Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✚ Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- ✚ Situacionin përfundimtar;
- ✚ Kontratë sipërmarrje;
- ✚ Faturat tatimore;
- ✚ Aktin e kolaudimit;

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✚ Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- ✚ Situacionin përfundimtar;
- ✚ Kontratë sipërmarrje;
- ✚ Faturat tatimore;
- ✚ Akt kolaudimi objekti;

**Shënim:** *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë

të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

N.P - 5/A Punime nëntokësore Ura e Vepra Arti;

N.P - 6/B Diga dhe tunele hidroteknike;

N.P - 12/B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

#### **PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

N.S - 1/A Punime për prishjen e ndëtimeve;

N.S - 4/A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;

N.S - 9/B Punime strukturore speciale;

N.S - 12/A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;

NS - 20/A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

#### **Argumentimi**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Kategoritë e licensës “N.P dhe N.S” të janë hartuar në përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gërmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës.

**✚ N.P 5/A - Punime nëntokësore Ura e Vepra Arti;**

Kjo pikë license është kërkuar bazuar në projektin e zbatimit, vendndodhjen e kryerjes së zbatimit të punimeve, i cili është në tunelin e shkarkimit të Digës së Zadejës në HEC Vau Dejës. Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

**✚ N.P - 6/B Diga dhe tunele hidroteknike;**

Kjo pikë license është kërkuar bazuar në projektin e zbatimit, vendndodhjen e kryerjes së zbatimit të punimeve, vendndodhjen e këtij projekti e cila është në tunelin e shkarkimit të Digës së Zadejës. Këto punime zënë një vlerë relativisht të lartë në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë B.

**✚ N.P - 12/B Punime të inxhinierisë së mjedisit.**

Kjo pikë license është kërkuar bazuar në projektin e zbatimit, vendndodhjen e kryerjes së zbatimit të projektit e cila është në tunelin e shkarkimit të Digës së Zadejës, për të bërë të mundur analizën dhe studimin e ndikimeve në mjedis, për të bërë të mundur eliminimin e dëmtimeve të disa zonave në brendësi të tunelit të shkarkimit pranë digës Zadejë, si dhe eliminimin e fenomeneve negative të kavitationit në këtë tunel. Këto punime zënë një vlerë relativisht të lartë në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë B.

**✚ N.S 1/A – Punime për prishjen e ndërtimeve**

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me prishjen e strukturave ndërtimore ekzistuese në pjesë të veçanta të tunelit sipas projektit të zbatimit. Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

**✚ N.S - 4/A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;**

Kjo pikë license është kërkuar bazuar në projektin e zbatimit, vendndodhjen e kryerjes së zbatimit të punimeve të konstruksione beton arme, plastikë metalike dhe rifiniture të cilat do të kryhen sipas projektit të zbatimit. Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

**✚ N.S - 9/B** Punime strukturore speciale;

Kjo pikë license është kërkuar bazuar në projektin e zbatimit, vendndodhjen e kryerjes së zbatimit ku përfshihen ankerat në tunel, strukturat monilite të betonit, konstruksionet metalike të përbëra sipas projektit të zbatimit. Këto punime zënë një vlerë relativisht të lartë në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë B.

**✚ N.S - 12/A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime të ndryshme ku përfshihen montimi dhe mirëmbajtja e sistemit ndricues dhe ventilues. Këto punime zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

**✚ NS 20/A** - Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë;

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime të ndryshme siç janë hapja e vrimave për inkastrimin e ankerave, të cilat zënë një vlerë relativisht të ulët në këtë projekt zbatimi dhe për pasojë vlerësohen si e kategorisë A.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 104 (Njëqind e katër) punonjës për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023).

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023).

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa Teknike se Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 104 (Njëqind e katër) punonjës, është në përputhje me objektin e prokurimit, rëndësisë së veprës, afatit kohor, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm në rastin konkret të konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Numri prej minimalisht 104 (Njëqind e katër) punonjës është gjykuar duke pasur parasysh të gjitha elementet e kësaj vepre, si volumi, natyra, afati i kontratës dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve në orare të caktuara sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi.

**2.3.4** Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023), stafi inxhinierik si më poshtë:

- + minimalisht 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi;
- + minimalisht 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- + minimalisht 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- + minimalisht 1 (një) Inxhinier Mjedisi;
- + minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- + minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeolog;

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- + Deklaratë e administratorit të shoqërisë se punonjësit e mësipërm janë pjesë e stafit dhe kanë kontratë pune të rregullt;
- + Diplomë;
- + CV;

***Argumentimi:***

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Prezenca e inxhinierëve me profilet e kërkuara është domosdoshmëri për zbatimin e këtij projekti referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

**Konkretisht:**

*Për sa i takon* inxhinierëve të ndërtimit janë kërkuar pasi referuar preventivit të punimeve si dhe kategorive të kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme prezenca e inxhinierëve të kërkuar, pasi të gjitha punime do të kryhen në një vepër të rëndësisë së veçantë sic

është tuneli i Zadejës ku inxhinierët e ndërtimit do të jenë përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit siç janë ankerat, strukturat monolite betoni, punimet e prishjeve të ndërtimit ekzistues etj.

*Për sa i takon Inxhinierit Hidroteknik është kërkuar kërkuar pasi referuar preventivit të punimeve si dhe kategorive të kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme prezenca e një inxhinieri hidroteknik, pasi punimet që do të kryhen mund të kenë impakt direkt ose indirekt në lidhje me punën e hidrocentralit dhe të gjitha punimet që kanë të bëjnë me profilin hidroteknik.*

*Për sa i takon Inxhinierit Elektrik është kërkuar kërkuar pasi referuar preventivit të punimeve si dhe kategorive të kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme prezenca e inxhinierit elektrik për të ndjekur zbatimin e të gjitha punimeve elektrike që do të kryhen.*

*Për sa i takon Inxhinierit të Mjedisit është kërkuar kërkuar pasi referuar preventivit të punimeve si dhe kategorive të kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme prezenca e inxhinierit të mjedisit për të evituar pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis, pasi këto punime do të realizohen në një pjesë shumë të rëndësishme të një vepre Hidroteknike, siç është HEC Vau Dejës.*

*Për sa i takon inxhinierit Mekanik, është kërkuar kërkuar pasi referuar preventivit të punimeve si dhe kategorive të kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme prezenca e inxhinierit mekanik pasi është i nevojshëm për sigurimin dhe mbarëvajtjen sa më mirë të të gjitha makinerive që do të punojnë për zbatimin e këtij projekti me sukses.*

*Për sa i takon inxhinierit Gjeolog, është kërkuar kërkuar pasi referuar preventivit të punimeve si dhe kategorive të kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, është e nevojshme prezenca e inxhinierit Gjeolog.*

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2023 – Korrik 2023), stafin mbështetës si më poshtë:

- ✚ minimalisht 2 (dy) teknik ndërtimi;
- ✚ minimalisht 3 (tre) elektrikist;
- ✚ minimalisht 1 (një) mekanik;
- ✚ minimalisht 3 (tre) hekurthyes;
- ✚ minimalisht 5 (pesë) karpentier;
- ✚ minimalisht 1 (një) saldator;
- ✚ minimalisht 2 (dy) punojës të pajisur me çertifikatë për punimet në lartësi;
- ✚ minimalisht 2 (dy) automakinist;
- ✚ minimalisht 2 (dy) shofer;
- ✚ minimalisht 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë” në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe



shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”;

✚ Të paktën 1(një) Inxhinier Mjedisi të pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

✚ Deklaratë e administratorit të shoqërisë se punonjësit e mësipërm janë pjesë e stafit dhe kanë kontratë pune të rregullt;

✚ Diplomë/çertifikatë/patenta sipas rastit.

### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Punonjësit e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në specififikimet teknike.

### **Konkretisht:**

✚ *Për sa i takon* teknikëve të ndërtimit, janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

✚ *Për sa i takon* elektrikistëve është kërkuar pasi të nevojshëm për kryerjen e instalimeve elektrike dhe realizimin e gjithë punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.

✚ *Për sa i takon* mekanikut është kërkuar pasi është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve sipas zërave të preventivit të punimeve.

✚ *Për sa i takon* hekurthyesëve janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hekurit në beton periodik dhe për realizimin e punimeve që kanë të bëjnë me ankerat referuar zërave të preventivit të punimeve.

- ✚ *Për sa i takon* karpentierëve janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve si punimet e hekurit të betonit dhe punimeve të ndryshme të ndërtimit për realizimin e këtij projekti zbatimi.
- ✚ *Për sa i takon* saldatorit, është kërkuar pasi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit që kanë të bëjnë me konstruksionet etalike të përbëra, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* punonjësve të pajisur me çertifikatë për punimet në lartësi janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të këtij projekti duke patur parasysh që terreni ku do të punohet është i thyer dhe me skarpata të lartësive të ndryshme.
- ✚ *Për sa i takon* automakinistëve janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për operimin e makinerive që do të përdoren për zbatimin me sukses të projektit sipas zërave të preventivit të punimeve.
- ✚ *Për sa i takon* shoferëve janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për transportimin e materialeve të ndryshme që do të përdoren për zbatimin e projektit sipas zërave të preventivit.
- ✚ *Për sa i takon* punonjësit i pajisur me çertifikatë për “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- ✚ *Për sa i takon* Inxhinierit të Mjedisit të pajisur me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” është kërkuar si kriter në mënyrë që kontraktori të këtë aftësinë e duhur dhe njohuritë e nevojshme për të realizuar punimet e kërkuara si dhe për te evituar pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis, pasi këto punime do të realizohen në një pjesë shumë të rëndësishme të një veprë Hidroteknike, siç është HEC Vau Dejës.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: 2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- c) ISO 45001-2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

**Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.*

**2.3.7** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për produktet dhe materialet e specifikuar në kriterin 2.3.8.

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*

#### **Argumentimi:**

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesve ose distributorëve të autorizuar për produktet dhe materialet e specifikuar në kriterin 2.3.8, është një dokument i rëndësishëm, i cili rrit sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të natyrës së veçantë të produkteve dhe matërijave që do të përdoret në funksion të realizimit të zërave përkatës referuar preventivit të punimeve që parashikon projekti objekt kontrate.

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.8** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët teknik për produktet dhe materialet e mëposhtme në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të parashikuara.

*Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

| Nr. | Emërtimi i produkteve   | Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes se katalogëve për çdo produkt, etj. | Kompania prodhuese, Ëeb, E-mail, Nr. kontakti |
|-----|---|--|---|
| 1   | EPORIP (a+b) OSE I NGJASHEM -refelojunispecifikimeve teknike. |  |   |
| 2   | ADESILEX PGI OSE I NGJASHEM -.                                |  |   |
| 3   | ADESILEX PG2 OSE I NGJASHEM                                   |  |   |
| 4   | MAPECURE SRA OSE I NGJASHEM -                                 |  |   |
| 5   | MAPEFER IK OSE I NGJASHEM                                     |  |   |
| 6   | MAPEGROUT T60 OSE I NGJASHEM.                                 |  |   |
| 7   | QUARZO 0,9; 1,2 OSE I NGJASHEM                                |  |   |

### **Argumentimi:**

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve dhe matërgjaleve të kërkuara.

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Mjetet | Sasia | Gjendja |
|--------|-------|---------|
|--------|-------|---------|

|  |                    |                     |
|--|--------------------|---------------------|
| Vinç me kapacitet mbajtës deri në 15 ton     | 1 copë             | Pronësi ose me qera |
| Kamiona                                      | 2 copë             | Pronësi ose me qera |
| Kamioncina                                   | 2 copë             | Pronësi ose me qera |
| Pompë betoni horizontale                     | 2 copë             | Pronësi ose me qera |
| Autobetoniere                                | 1 copë             | Pronësi ose me qera |
| Saldatriçe                                   | 1 copë             | Pronësi ose me qera |
| Matrapik                                     | 3 copë             | Pronësi ose me qera |
| Skeleri                                      | 700 m <sup>2</sup> | Pronësi ose me qera |
| Rripa sigurimi për punonjësit në lartësi     | 5 copë             | Pronësi             |
| Komplet i ndihmës së shpejtë                 | 5 copë             | Pronësi             |
| Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt | 10 copë            | Pronësi             |
| Kokore                                       | 100 copë           | Pronësi             |

**“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

c) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh. **Faturë tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuar.**

*Atoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*Specifikimet teknike janë hartuar për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.*

#### **Njësia e prokurimit**